



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" nenit 5, lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 27.02.2019, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**JEPET PËLQIMI**- për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës, për interes publik;

**Parcela**, kadastrale, **P-72116046-02785-79**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **39779m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **nr.2785-79**, datës 25.02.2019, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura "**Shiroko**" e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, me destinim sipas planit rregullativ të zonës industriale "Shkollë Bujqësore", nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **10967m<sup>2</sup>** për ndërtimin e shkollës profesionale me kuadër të kualifikuar me nivelin e shkallës së 5, (pestë) drejtimi "Mekatronik".

### Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" dhe të Rregullores (QRK), Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-14332  
Më datë 28.02.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI